



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PORTI DETAR SHA SARANDË
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr.169/2. Prot.

Sarandë, më.22.04.2024

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Blerje Materiale Higjeno-Sanitare dhe pastrimi”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

44411000-4 Sanitare, 33771000-5 Produkte sanitare letre, 33711900-6; sapuni,39224100-9; fshese,39224330-0; kove, 39224320-7; sfungjer, 39831200-8- Detergjente, 33761000-2- leter higjenike, 24311900-6- klor, 39830000-9- produkte pastrimi, 39831300-9- pastrues dysHEMEJE, 39831600-2- pastrues tualeti

PROCEDURA : "E hapur e thjeshtuar" Mall, (elektronikë).

BURIMI: Vetëfinancim

AFATI : 9 muaj

REFERENCA : Programi Ekonomik i Shoqërisë për vitin 2024

NJËSIA E PROKURIMIT: Urdhër Nr.4 datë 03.01.2024

Krenar Bedaj - Kryetar

Rovena Ali - Anëtar

Anisa Hysi - Anëtar

VLERA E FONDIT LIMIT: 1.330.242 (një milion e treqind e tridhjetë mijë e dyqind e dyzet e dy) lekë pa TVSH.

KODI OUTPUT: 0000000

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Porti Detar Sha Sarandë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Sigurimi i Ofertës: Në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", Neni 83: Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës. Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është 2% e fondit limit pa TVSH: 26,605 (njëzet e gjashtë mijë e gjashtëqind e pesë) lekë pa tvsh.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

c. *Formulari i ofertës sipas Shtojcës 1 dhe Shtojcës 2*

Argumentimi: Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik" dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, cdo operator ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë pjesë të ofertës së tij edhe formularin e ofertës sipas Shtojcës 1 dhe Shtojcës 2 të Dokumenteve Standarte të Tenderit.

d. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.8 (Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit). Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë përpara nënshkrimit të kontratës dokumentin e deklaruar ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Njësia e Prokurimit e ka hartuar këtë kriter duke u bazuar në pikën 7, gërma" a", neni 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, për të provuar se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik.

a) Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale.

b) Të jetë i specifikuar në QKB objekti i veprimtarisë së operatorit ekonomik i njëjtë ose ekuivalent me objektin e prokurimit.

Sipas përcaktimeve të bëra në Shtojcën 7 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit**).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, nenin 40 pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën njërin nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë **jo më e vogël se** 40% e vlerës së parashikuar të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke qenë se lloji i procedurës është "Procedurë e hapur e thjeshtuar", përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 2, gërma "c" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, ku përcaktohet se: "*Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: b) 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar.....*";

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1 " të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet se: "*Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare*".

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Operatorët Ekonomik duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2022,2023) i miratuar, si dhe vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika c të ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 " Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, ku bilancet e kërkuara nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: *"Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.*

2.2.3. Operatori Ekonomik duhet të paraqese një dokument që verteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2022 (sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin 9632/2006 "Per sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 "Per procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 "Per QKB" i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 "Per QKR" i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që

operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat (furnizimet) e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate, për furnizime të ngjashme të kryera tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Subjekti ofertues, në lidhje me periodicitetin e lëvrimit të mallit, duhet të paraqesë deklaratën si mëposhtë:

- a) Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë deklaratë që merr përsiper transportin e mallrave objekt prokurimi, në ambjentet e AK, në jo më pak se 9 (nëntë) furnizime sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.
- b) Operatori ekonomik duhet të deklarojë se nëse shpallet fitues, mallrat do të jenë të njëjtë me mostrat e paraqitura ditën e zhvillimit të procedurës së prokurimit.
- c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për skadencën e mallrave, e cila duhet të jetë jo më pak se 1 (një) vit nga momenti i lëvrimit të mallit.

Mosdeklarimi si më sipër, përbën kusht për skualifikim.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 15 pika 3/b, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që "Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimit të mallrave".

Argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri ka ardhur sepse hapësirat e magazinimit të mallit të institucionit janë aktualisht tepër të kufizuara.

GRAFIKU I LËVRIMIT TË MALLIT NË 9 MUAJ

N r	Artikulli	Njësia	Sasia Total	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	Qeska mbeturinash 140 litroshe	kg	600	Porti Detar Sarandë	Brenda datës 30 të çdo muaji.Sipas grafikut të lëvrimit
2	Qeska mbeturinash 100 litroshe	kg	400	Porti Detar Sarandë	Brenda datës 30 të çdo muaji.Sipas grafikut të lëvrimit
3	Qeska mbeturinash 10 litroshe	kg	300	Porti Detar Sarandë	Brenda datës 30 të çdo muaji.Sipas grafikut të lëvrimit
4	Leter Higjenike	rolo	6,500	Porti Detar Sarandë	Brenda datës 30 të çdo muaji.Sipas grafikut të lëvrimit
5	Acid per WC	litër	400	Porti Detar Sarandë	Brenda datës 30 të çdo muaji.Sipas grafikut të lëvrimit
6	Solucion per larjen e dyshemese	litër	800	Porti Detar Sarandë	Brenda datës 30 të çdo muaji.Sipas grafikut të lëvrimit
7	Klor xhel	litër	800	Porti Detar Sarandë	Brenda datës 30 të çdo muaji.Sipas grafikut të lëvrimit
8	Sfungjere mesatar	copë	50	Porti Detar Sarandë	Brenda datës 30 të çdo muaji.Sipas grafikut të lëvrimit
9	Peceta pastrimi	copë	20	Porti Detar Sarandë	Brenda datës 30 të çdo muaji.Sipas grafikut të lëvrimit
10	Doreza llastiku njperdorimshme	Pako	15	Porti Detar Sarandë	Brenda datës 30 të çdo muaji.Sipas grafikut të lëvrimit
11	Tabele sinjalizimi per dyshemene e njome	copë	5	Porti Detar Sarandë	Brenda datës 30 të çdo muaji.Sipas grafikut të lëvrimit
12	Shtupa Pastrimi	copë	30	Porti Detar Sarandë	Brenda datës 30 të çdo muaji.Sipas grafikut të lëvrimit
13	Bishta fshese/shtupe	copë	50	Porti Detar Sarandë	Brenda datës 30 të çdo muaji.Sipas grafikut të lëvrimit
14	Fshesa pastrimi	copë	50	Porti Detar Sarandë	Brenda datës 30 të çdo muaji.Sipas grafikut të lëvrimit
15	Sapun leng	litër	500	Porti Detar Sarandë	Brenda datës 30 të çdo muaji.Sipas grafikut të lëvrimit

16	Shtrydhese per kove	copë	5	Porti Detar Sarandë	Brenda datës 30 të çdo muaji.Sipas grafikut të lëvrimit
17	Kove pastrimi+shtrydhese	copë	5	Porti Detar Sarandë	Brenda datës 30 të çdo muaji.Sipas grafikut të lëvrimit
18	Kosh mbeturinash metalik per zyra	copë	10	Porti Detar Sarandë	Brenda datës 30 të çdo muaji.Sipas grafikut të lëvrimit
19	Zhbllokues lavamanesh dhe wc	litër	20	Porti Detar Sarandë	Brenda datës 30 të çdo muaji.Sipas grafikut të lëvrimit
20	Farashan me bisht	copë	10	Porti Detar Sarandë	Brenda datës 30 të çdo muaji.Sipas grafikut të lëvrimit
21	Solucion antikalkar	litër	10	Porti Detar Sarandë	Brenda datës 30 të çdo muaji.Sipas grafikut të lëvrimit
22	Klor per shatervan	kg	10	Porti Detar Sarandë	Brenda datës 30 të çdo muaji.Sipas grafikut të lëvrimit
23	Furce per pastrimin e WC	copë	10	Porti Detar Sarandë	Brenda datës 30 të çdo muaji.Sipas grafikut të lëvrimit
24	Fshirese merimangash	copë	5	Porti Detar Sarandë	Brenda datës 30 të çdo muaji.Sipas grafikut të lëvrimit
25	Kuti e ndihmes se shpejte	copë	4	Porti Detar Sarandë	Brenda datës 30 të çdo muaji.Sipas grafikut të lëvrimit
26	Pompe zhbllokimi ëc/lavamane	copë	5	Porti Detar Sarandë	Brenda datës 30 të çdo muaji.Sipas grafikut të lëvrimit
27	Solucion per larjen e xhamave	litër	40	Porti Detar Sarandë	Brenda datës 30 të çdo muaji.Sipas grafikut të lëvrimit
28	Gomine per pastrimin e xhamave	copë	10	Porti Detar Sarandë	Brenda datës 30 të çdo muaji.Sipas grafikut të lëvrimit
29	Aparat per aromatizim	copë	10	Porti Detar Sarandë	Brenda datës 30 të çdo muaji.Sipas grafikut të lëvrimit
30	Spray aromatic per aparatet	copë	50	Porti Detar Sarandë	Brenda datës 30 të çdo muaji.Sipas grafikut të lëvrimit

31	Detergjent pluhur	Kg	10	Porti Detar Sarandë	Brenda datës 30 të çdo muaji.Sipas grafikut të lëvrimit
32	Pastrues per WC ne forme tablete	copë	200	Porti Detar Sarandë	Brenda datës 30 të çdo muaji.Sipas grafikut të lëvrimit
33	Leter pastrimi per duart	Rolo	150	Porti Detar Sarandë	Me dy shtresa me ngjyre te bardhe. Pesha 1.7-2kg, 600 fije

Grafiku i lëvrimit të mallit nga muaji Maj deri në muajin Janar.

ARTIKUJT	NJËSIA	Sasia	M	Q	K	G	SH	T	N	DH	J
		Total									
Qeska mbeturinash 140 litorshe	kg	600	0	0	100	100	100	100	100	100	0
Qeska mbeturinash 100 litroshe	kg	400	50	50	50	50	50	50	50	50	0
Qeska mbeturinash 10 litroshe	kg	300	0	0	0	60	60	60	60	60	0
Leter Higjenike	rolo	6,500	500	500	1000	1000	1000	1000	1000	250	250
Acid per WC	liter	400	40	40	40	40	80	40	40	40	40
Solucion per larjen e dyshemese	liter	800	50	50	100	150	200	100	100		50
Klor xhel	liter	800	50	50	100	150	150	100	100	50	50
Sfungjere mesatar	copë	50	50	0	0	0	0	0	0	0	0
Peceta pastrimi	pako	20	20	0	0	0	0	0	0	0	0
Doreza llastiku njeperdorimshe	pako	15	15	0	0	0	0	0	0	0	0
Tabele sinjalizimi per dyshemene e njome	copë	5	5	0	0	0	0	0	0	0	0
Shtupa Pastrimi	copë	30	30	0	0	0	0	0	0	0	0
Bishta fshese/shtupe	copë	50	50	0	0	0	0	0	0	0	0

Fshesa pastrimi	copë	50	50	0	0	0	0	0	0	0	0
Sapun leng	liter	500	50	50	50	50	100	50	50	50	50
Shtrydhese per kove	copë	5	5	0	0	0	0	0	0	0	0
Kove pastrimi+shtrydhese	copë	5	5	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosh mbeturinash per zyra	copë	10	10	0	0	0	0	0	0	0	0
Zhbllokues lavamanesh dhe ëc	liter	20	20	0	0	0	0	0	0	0	0
Farashan me bisht	copë	10	10	0	0	0	0	0	0	0	0
Solucion antikalkar	liter	10	10	0	0	5	0	0	0	0	0
Klor per shatervan	liter	10	10	0	0	0	0	0	0	0	0
Furce per pastrimin e WC	copë	10	10	0	0	0	0	0	0	0	0
Fshirese merimangash	copë	5	5	0	0	0	0	0	0	0	0
Kuti e ndihmes se shpejte	copë	4	4	0	0	0	0	0	0	0	0
Pompe zhbllokimi wc/lavamane	copë	5	5	0	0	0	0	0	0	0	0
Solucion per larjen e xhamave	liter	40	5	5	5	10	10	5	0	0	0
Gomine per pastrimin e xhamave	copë	10	10	0	0	0	0	0	0	0	0
Aparat per aromatizim	copë	10	10	0	0	0	0	0	0	0	0
Spary aromatik per aparatet	copë	50	50	0	0	0	0	0	0	0	0
Detergjent pluhur	kg	10	10	0	0	0	0	0	0	0	0

Pastrues per WC ne forme tablete	copë	200	20	20	30	40	40	20	10	10	10
Leter pastrimi per duart	rolo	150	20	20	20	20	20	20	10	10	10

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

ISO 9001:2015 “Për Menaxhimin e Cilësisë”

Shënim: *Certifikata e mësipërme/ekuivalente duhet të jetë e lëshuar nga Institucione të certifikuar/akredituara në Shqipëri ose tek ato ndërkombetare dhe në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë certifikatë në përputhje me shërbimet që ka marrë përsipër në marrëveshjen e bashkëpunimit.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 44 pika 1 dhe 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Për vet natyrën e kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatori ekonomik të jetë i certifikuar me certifikatën ISO 9001:2015. Kjo certifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe në rekomandimin e APP dhe Drejtorisë së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë”.

2.3.4 Operatori ekonomik ditën e zhvillimit të tenderit duhet të paraqesë fizikisht mostrat për artikujt e tabelës së mëposhtëme, të shoqëruara me (Skedat teknike).

Skedat duhet të jenë në gjuhën shqipe dhe nëse janë në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer e të noterizuara. Në skedat teknike duhet të dallohet qartë përputhja e të gjitha karakteristikave (specifikimeve teknike) të kerkuara me produktet e ofruara.

Nr. sipas Preventivit	Emërtimi
1	Qeska 140 litorshe
4	Letër higjenike (rolo)
6	Solucion për larjen e dyshemesë
12	Shtupa pastrimi
17	Kovë pastrimi+shtrydhëse
28	Gominë për pastrimin e xhamave
30	Spray aromatik për aparatet

Operatori ekonomik ditën e zhvillimit të tenderit duhet të paraqesë fizikisht mostrat për artikujt e tabelës së mësipërme (nga një muster për secilin artikull).

- Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit në ambientet e protokollit të AK
- Çdo muster e paraqitur pas orarit të përcaktuar për hapjen e procedurës nuk do të pranohet.
- Mostrat e kërkuara duhet detyrimisht të jenë të vullosura me vulën e ofertuesit, emrin e ofertuesit, datën e zhvillimit të tenderit, të nënshkruara në vende të dallueshme dhe të ketë numrin rendor korespondues me emrin e artikullit.
- Mostrat duhet të përputhen me cilësimet e dhëna në specifikimet përkatëse. Nëse mostrat nuk janë sipas specifikimeve OE do të skualifikohet.
- Mosparaqitja e mostrave, skedave teknike ditën e zhvillimit të tenderit është kusht për skualifikimin e operatoreve.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 6 “a”, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Udhezimit të APP-së Nr.3 datë 12.04.2022 “Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë” Kriteri i vendosur për paraqitjen e mostrave është kërkuar për të siguruar AK-ja, për plotësimin e kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike ku mostra e kërkuar do të shfaqë cilësinë e produktit final i cili do të lëvrohet nga OE fitues gjatë gjithë zbatimit e kontratës.

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet: *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”,* si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”*, **sjellim në vëmendje se:**

- Disponimi i dokumentave të kërkuara më sipër do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet t’i dërgojë kërkesë në rrugë elektronike (nëpërmjet sistemit të APP) ofertuesit të kualifikuar i pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.
- Mosparaqitja e dokumentacionit do të jetë kusht s’kualifikimi si dhe do të veprohet sipas nenit 83 pika 3 dhe 5 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimet e bera gjate fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetedeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36, te LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, sipas shkresës Nr.2065 Prot, date 12.04.2022.

Në specifikimet teknike që janë hedhur në dokumentet teknike të tenderit nuk është përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

N R	ARTIKUJT	NJËSIA	SPECIFIKIMET TEKNIKE
1	Qeska mbeturinash 140 litroshe	kg	material plastik I forte
2	Qeska mbeturinash 100 litroshe	kg	material plastik I forte
3	Qeska mbeturinash 10 litroshe	kg	material plastik I forte
4	Leter Higjenike	rolo	Letër higjenike (rulo) , me 3 fije, 200 gr/rulo
5	Acid per WC	litër	Acid klorhidrik, Gërryes-hidhet direkt në sipërfaqen për pastrim dhe shplahet me ujë.-pastrim banjo-hollohet në varësi të shkallës së papastërtisë
6	Solucion per larjen e dyshemese	litër	Solucion larës për pllaka dyshemeje, në paketim 5 litër . Të jetë aktiv, me fuqi larëse të njollave dhe papastërtive në pllaka i ambalazhuar në enë plastike dhe aromatik. Ambalazhi të përmbajë të dhënat e prodhuesit si dhe barkodin përkatës.
7	Klor xhel	litër	Klor I përqendruar, në formë xheli, me arome. Ambalazhi plastik jo më pak se 1 litër. Ambalazhi të përmbajë të dhënat e prodhuesit si dhe barkodin përkatës..

8	Sfungjere mesatar	copë	Sfungjer pastrimi me shkallë ferkimi të lartë Përmasat: minimumi 9 x 14 cm Materiali : sfungjer sintetik+abraziv.
9	Peceta pastrimi	copë	Pecetë pastrimi, prej materiali mikrofibre poliestre të butë, në ngjyra të ndryshme. Përdoret për pastrimin e sipërfaqeve të xhamave, sipërfaqeve të inoksit, drurit apo sipërfaqeve të brendshme dhe të jashtme , duke hequr pluhurat dhe papastërtitë e tjera pa lënë njolla apo shenja. Mund të përdoret me ujë, me detergjentë të ndryshëm pastrimi ose në të thatë. dhe mund të lahet lehtësisht në lavatriçe, mikrofiber 100%
10	Doreza llastiku njëpërdorimshme	Pako	Doreza pune me material llastiku. Përdoren gjerësisht për punë por edhe për pastrim, Masa M-L. Paketimi I nje pakoje duhet te permbaje 100 copë doreza
11	Tabele sinjalizimi per dyshemene e njome	copë	Permasa 50x20x60 cm, shqip-anglisht, ngjyra e verdhe
12	Shtupa Pastrimi	copë	Shtupa me përbërje mikrofibër të dendur për pastrimin e dyshemesë me fileto të gjerë, 300 gr
13	Bishta fshese/shtupe	copë	Shkop për fshesa/shtupa Përmasat: 100-180 cm. Materiali inoks. Filetoja te pershtatet per shtupen e pastrimit
14	Fshesa pastrimi	copë	Fshesë plastike e butë me fije te gjata dhe te plota për përdorim në ambiente të brendshme. Filetoja te pershtatet me bishtin e fsheses
15	Sapun leng	litër	Sapun i lëngshëm, anti-bakterial ose anti-mikrobial, me aftësi shkumuese të lartë,i butë për lëkurën dhe e testuar dermatologjikisht, me paketim plastik, pa alkool. Amballazhi të përmbajë të dhënat e prodhuesit si dhe barkodin përkatës .
16	Shtrydhese per kove	copë	material plastik, te pershtatet me kovat (artikulli 19)
17	Kove pastrimi+shtrydhese	copë	10-15 l, material plastik I forte, me parete te trasha, rezistente me paisje turbo te montuara ne koke qe ben shtrydhjen e shtupes komplet.
18	Kosh mbeturinash metalik per zyra	copë	Kosh mbeturinash për zyre në ngjyrë të zezë, 5 litër , plastik I forte, me ø30 cm dhe lartesi 32 cm
19	Zhbllokues lavamanesh dhe wc	litër	Pastrues universal per pastrim lavamani ose ekuivalent. Paketim jo me I vogel se 750 ml. Detergjent I lengshem me nje formule te pasuruar me perberes aktiv, me veprim zbardhues dhe antibakterial pa permbajtje klori. Heq aromat e këqija dhe zhbllokon lavamanët dhe ëc me ujë të ngrohtë dhe të ftohtë,

			Ambalazhi te permbaje emrin e prodhuesit dhe barkodin perkates.
20	Farashan me bisht	copë	material plastik, me bisht te gjate
21	Solucion antikalkar	litër	Solucion kundra oksidimit të paisjeve hidrosanotare. Konkretisht, për pastrimin e smërçit, mikrobeve, etj, të ketë aftësi pastruese në çfarë do lloj sipërfaqeje, me sprucator. Ambalazhi plastik jo më pak se 750 ml dhe të përmbajë të dhënat e prodhuesit si dhe barkodin përkatës.
22	Klor per shatervan	kg	Klor pluhur per pastrimin e ujit te shatervanit nga kriprat, myshqet dhe bakteret e tjera ,Ambalazhi te permbaje emrin e prodhuesit dhe barkodin perkates,
23	Furce per pastrimin e WC	copë	Material plastik, furce me fije te dendura per pastrimin e tualeteve nga papastertite
24	Fshirese merimangash	copë	Fshirese me bisht te gjate qe perdoren per heqjen e merimangave ne lartesi te mureve
25	Kuti e ndihmes se shpejte	copë	material metalik, I montuesehm ne mur, I pajisur me cdo element te ndihmes se shpejte (locione per pickimet e insekteve, garza, termometer, gershere, alkool, betadine, qetesues per dhimbjet e zakonshme)
26	Pompe zhbllokimi wc/lavamane	copë	pompe zhbllokuese per tubacionet, lavaman, ëc, pileta shkarkimi
27	Solucion per larjen e xhamave	litër	Solucioni te jete i formuluar për të hequr papastërtitë e xhamit tuaj për një shikueshmëri më të qartë, pa lene shenja dalluese
28	Gomine per pastrimin e xhamave	copë	Larës për xhamat e dritareve metalike me dorezë 30 cm. Tharësi i xhamave është gjithashtu i pajisur me gominë, për të hequr papastërtitë në xhama.
29	Aparat per aromatizim	copë	Shperndan aromen per ambjentin. Me 3 intervale shkrepje – 9, 18 dhe 36 minuta. Mund të përdoret me të gjitha aromat e rimbushjes
30	Spray aromatic per aparatet	copë	Aroma tnatyrore që zgjasin shumë ndërsa vrasin bakteret dhe largojnë erën e keqe. Jasmine,Lavender,Ocean,Limon,Trendafil I bardhe
31	Detergjent pluhur	Kg	Detergjent per larje me arome te fresket me nje formule inovative e cila deperton ne thellesi per te zhdukur shenjat e papasteritve dhe njollave, deri tek ato me te veshtirat. Ruan freskine dhe aromen per nje kohe te gjate.

32	Pastrues per WC ne forme tablete	copë	Tablete pastrimi per WC te cilat hidhen ne kazanin e shkarkimit, te cilat ndihmojne per dizinfektim dhe per largimin e aromave te pakendshme.
33	Leter pastrimi per duart	Rolo	Me dy shtresa me ngjyre te bardhe. Pesha 1.7-2kg, 600 fije

NJËSIA E PROKURIMIT